



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2023

DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM
(01 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023)



Miratoj:
Drejtori për EZH
Isuf Demhasaj

Deçan, 2023

		SHKURTORI DEÇANI - LISTA NR.	
REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKI KOMUNALE DEÇANI - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANI		MUNICIPALITY OF DEÇAN - DEÇAN MUNICIPALITY	
NR. I DOKUMENTIT	NR. I DOKUMENTIT	NR. I DOKUMENTIT	NR. I DOKUMENTIT
DR. EKONOMI	11	2783	26.01.23
NR. I DOKUMENTIT	NR. I DOKUMENTIT	NR. I DOKUMENTIT	NR. I DOKUMENTIT
NR. I DOKUMENTIT	NR. I DOKUMENTIT	NR. I DOKUMENTIT	NR. I DOKUMENTIT

I nderuar Kryetar,

I nderuar Nënkyetar,

Përmes Planit të Punës të vitit 2023, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ju njofton për punët dhe aktivitet që synon të i realizojmë gjatë këtij viti.

Emri i planit të punës:

Deçani qendër e vlerave natyrore dhe turistike

Periudha e implementimit të planit të punës:

01.01.2023-31.12.2023

Territori i implementimit të planit të punës:

Komuna e Deçanit (zona urbane, rurale dhe malore)

Përmbajtja e planit të punës:

1. Përfituesit përfundimtar të Planit të Punës.....	4
2. Misioni i planit të punës.....	4
3. Qëllimi i planit të punës.....	5
4. Objektivat e planit të punës.....	5
5. Plani i aktiviteteve dhe projekteve 2023.....	6

Përfituesit përfundimtar të Planit të Punës:

Qytetaret e Komunës së Deçanit, (pronaret e bizneseve prodhuese dhe tregtare, pronaret e hoteleve dhe bujtinave dhe organizata jo-qeveritare lokale dhe tour operatorët lokal)

Misioni i Planit të Punës:

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka për mision krijimin e mundësive për zhvillim ekonomik dhe turistik të komunës, përmbushjen e strategjive dhe Planit Zhvillimor Komunal për krijimin e kushteve për promovimin e vlerave rurale e malore turistike të komunës, mbështetjen e bizneseve të vogla, të mesme dhe të mëdha që janë prodhuese dhe tregtare dhe rritjen e punësimit në komune. Krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve hoteliere dhe bujtinave si zonat rurale dhe malore, ngritjen e kampeve në Bjeshkët e Deçanit dhe shenjzimin e të gjitha shtigjeve për ciklizëm dhe ecje, shtigjeve tjera në të gjitha 18-te bjeshkët e Deçanit.

Plani i punës i drejtorisë ka për mision krijimin e pakos turistike të komunës si anën digjitale dhe përmes broshurave dhe formave të ndryshme të promovimit si në mediat vendore dhe ndërkombëtare të vlerave natyrore dhe kulturore të komunës. Krijimin e bashkëpunimit me organizata qeveritare dhe jo-qeveritare, ndërkombëtare, zhvillimin ekonomik dhe turistik dhe ngritjen e fondeve për këto fusha.

Nxitjen e bizneseve, organizatave qeveritare dhe jo qeveritare dhe tour operatoreve lokal, shoqatave bjeshkatore për zhvillimin dhe promovimin e turizmit verorë dhe dimërorë dhe rritjen e numrit të turistëve si në zonat rurale ashtu malore.

Qëllimi i Planit të Punës:

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim sipas Statuti të Komunës së Deçanit, të datës:07.11.2019, ka në kuadër të saj sektorin për zhvillim ekonomik dhe sektorin për turizëm, ka tre punëtorë : drejtorin, shefin e zyrës për ekonomi dhe zhvillim dhe zyrtaren për biznese. Ndërsa ka përgjegjësi dhe qëllim sipas dispozitave ligjore zhvillimin ekonomik dhe të turizmit, hartimin e projekteve strategjike dhe zhvillimore të komunës, plane për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës, plane për shfrytëzimin e burimeve ekonomike të komunës, krijon kushte të qëndrueshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Harton plane strategjike për zhvillim të turizmit me harmoni me planet dhe strategjitë lokale dhe qendrore në Republikën e Kosovës, ka për qëllim promovimin e turizmit dhe vlerave natyrore dhe kulturore të komunës, mbështetjen dhe zhvillimin e kapaciteteve turistike të komunës dhe bizneseve prodhuese dhe tregtare në komune, krijimin e kushteve më të mira për jetesë si në aspektin ekonomik dhe social të qytetareve dhe përmasimin e gjendjes së punësimit në komune.

Objektivat e planit të punës:

1. Zhvillimi ekonomik dhe social i komunës
2. Promovimin i turizmit veror dhe dimëror
3. Ngritja e kapaciteteve turistike të komunës
4. Fuqizimi dhe mbështetja e bizneseve prodhuese dhe tregtare lokale
5. Krijimi i brendeve të ndryshme prodhuese
6. Ruajtjen dhe promovimin e vlerave natyrore, tradicionale, kulturore dhe fetare të komunës

AKTIVITETI	BARTESI	PERIUDHA IMPLMENTIMIT	FONDET	REZULTATET E PRITURA	RREZIQET
1.Regjistrim Bizneseve dhe shërbime tjera rreth kërkesave të bizneseve	DEZH ARBK	Janar 2023 Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit ARBK	-Shërbime me të mira për bizneset lokale. -Fuqizimi i bizneseve. -Mbështetja dhe informimi i bizneseve.	-Mos kryerja e dokumenteve me kohe e bizneseve. -Ligjet jo të favorshme për biznese. -Mungesa e mjeteve financiare për mbështetjen e bizneseve.
2.Panairi Veror-2023	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore, Organizatat Jo-Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare Bizneset lokale prodhuese vendore dhe të vendeve fqinje	Qershor 2023	Komuna e Deçanit	-Promovimi i produkteve vendore. -Krijimi i bashkëpunimit mes bizneseve. -Shitja dhe marketingu i bizneseve prodhuese lokale. -Promovimi i produkteve vendore.	-Mos pjesëmarrja e bizneseve në panair. -Mungesa e mjeteve financiare për organizuar panairin.
3.Projekte kapitale për promovimin e turizmit dhe ngritjen e kapaciteteve turistike	Komuna e Deçanit DEZH Donator Vendor dhe Ndërkombëtar	Janar 2023 Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit-Mjete Kapitale Institucione Qendrore Organizata Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtarë Bizneset Lokale	-Promovimi i turizmit veror dhe dimëror në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar -Ngritja kapaciteteve turistike si në zonat rurale dhe malore. -Ngritja e kapaciteteve	-Mungesa e mjeteve financiare. -Mungesa e kapaciteteve profesionale. -Mungesa e bashkëpunimit dhe tour operatoreve lokal. -Mungesa e shoqatave

				shërbyese me të mira për turistë. -Krijimi i mundësive për zhvillim ekonomik dhe punësim.	bjeshkatore lokale.
4.Krijimi i bashkëpunimit me pronaret e kullave, bujtinave, tour operatoreve lokale dhe rajonal, shoqatave bjeshkatore lokale dhe rajonale dhe objekteve fetare dhe krijimi i bazës së të dhënave për numrin turistëve dhe kërkesave dhe nevojave të tyre.	DEZH, Pronaret e kullave, Bujtinave dhe Përfaqësuesit e Objekteve Fetare, Shoqatat Bjeshkatore Lokale dhe Rajonale, Tour Operoret Lokale dhe Rajonal, Agjenci të ndryshme.	Janar 2023 Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit Fonde nga Organizata Jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtarë	-Krijimi i bazës së të dhënave për numrin e turistëve. -Bashkëpunimi me i mire mes institucioneve dhe përfaqësuesve tjerë lokal. -Shërbime me të mira për turistet. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	-Mos bashkëpunimi i duhur i personave relevant ne këto fusha. -Mos regjistrimi i turistëve gjatë vizitave të tyre ne zonat rurale dhe malor. -Mungesa mjeteve financiare dhe kapacitet profesionale.
5.Festivali i punimeve artizanale dhe ushqimeve tradicionale	DEZH Donator Qeveritare dhe Jo-qeveritare, Prodhuesit e Punimeve Artizanale, Ushqimit etj.	Gusht 2023	Komuna e Deçanit Fonde nga Organizata Jo-Qeveritare vendore dhe ndërkombëtarë	-Promovimi prodhimeve vendore me pune dore. -Mbështetja prodhueseve artizanal (veçanërisht grave). -Ruajtja e vlerave kulturore dhe tradicionale.	-Mungesa e mjeteve financiare për organizmin e festivalit. -Kushtet klimatike. -Mos krijimi i bashkëpunimit mes institucioneve dhe prodhueseve të punimeve artizanale.
6.Formimi i ofertës-Pakos turistike për zonat rurale dhe malore ne Komunën e Deçanit.	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe Ndërkombëtar	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit Fonde nga Organizata Jo-qeveritare	-Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të komunës.	-Mungesa e mjeteve financiare për krijimin e ofertës turistike.

	Shoqatat Bjeshkatore, Tour Operaroret, Ekspert te fushës Se Ekonomis dhe Turizmit		vendore dhe ndërkombëtarë .	-Shërbime me të mira turistike si në zonat rurale dhe malore. -Krijimi pakos digjitale për promovimin e vlerave turistike. -Rritja e vizitoreve në zonat rurale dhe malore dhe ngritja e kapaciteteve mikpritëse profesionale	-Kushtet klimatike -Mungesa e kapaciteteve profesionale dhe shoqatave lokale. -Mos informimi apo pasqyrimi jo i duhur medial dhe në rrjetet sociale.
7. Shenjzimi i shtigjeve për ecje dhe çiklizëm dhe shtigjeve tjera ne zonat rurale dhe malore ne 18-te Bjeshkët e Komunës së Deçanit	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe Ndërkombëtar Shoqatat Bjeshkatore, Tour Operaroret, Ekspert të fushës se Ekonomisë dhe Turizmit	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe Ndërkombëtar Shoqatat Bjeshkatore, Tour Operaroret,	-Shenjzimi i të gjitha shtigjeve për ecje dhe çiklizëm. -Shërbime me të mira për turistë. -Informimi me i mire për turistet.	-Mungesa e mjeteve financiare. -Kushtet klimatike. -Shkatërrim i tabelave dhe shenjave për ecje dhe çiklizëm. -Mos publikimi ne rrjet të ndryshme sociale i shtigjeve.
8. Subvencione dhe mbështetje financiare për bizneset prodhuese, bizneset e vogla dhe te mesme	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qeveritare dhe Ndërkombëtarë Organizatat Jo-Qeveritare Bizneset në Deçan	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit Organizata Jo-Qeveritare Vendore dhe Rajonal, Ndërkombëtare	-Nxitja e te rinjeve për hapje bizneseve. -Mbështetje bizneseve ekzistuese. -Fuqizimi i bizneseve lokale dhe krijimi i vendeve te reja punës dhe	-Mungesa e mjeteve financiare -Procedurat aplikuese. -Mos plasimi i duhur ne tregun lokal dhe rajonal i prodhimeve.

				<p>zhvillimi ekonomik i komunës.</p> <p>-Krijimi i mundësive me të mira për pune.</p> <p>-Krijimi i bashkëpunimit ma të mire mes institucioneve dhe qytetareve.</p> <p>-Krijimi i mundësive për bizneset lokale dhe prodhuesit vendore për pjesëmarrje ne panairë të ndryshme ne vende dhe jasht vendit.</p>	
09.Mbatja e kampit veror për te rinjtë	Komuna e Deçanit DEZH	Gusht 2023	Komuna e Deçanit DEZH	<p>-Promovimi i turizmit përmes kampingut një ditore breg Lumit te Lumbardhit te Deçanit.</p> <p>-Njoftimi me pajisjet e kampingut dhe rendësin e tije</p> <p>-Shfrytëzimi i lumit dhe bukuris se tij.</p> <p>-Njoftimi me Via Ferrata si atraksion turistik</p>	<p>-Mos pjesëmarrja ne kamping e te rinjeve</p> <p>-Kushtet klimatike</p>
10.Inicimi dhe krijimi i Brendit të produkteve vendore lokale (prodhimit te qumështi, pemëve dhe mjaltës dhe	Komuna e Deçanit, Prodhuesit Lokale, Institucionet	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit Organizata Jo-Qeveritare Vendore dhe Rajonal,	-Promovimi i produkteve natyrale dhe tradicionale të komunës.	<p>-Procedurat për njohje e brendit të vështira.</p> <p>-Mungesa e mjeteve financiare për</p>

gështenjës, ujit natyral dhe ujit mineral etj.)	vendore dhe Ndërkombëtare, Ekspert të fushave të ndryshme		Ndërkombëtare	-Fuqizimi i prodhueseve vendore dhe zhvillimi ekonomik i komunës. -Ruajtja e vlerave lokale dhe krijimi i mundësive për bizneset. -Bashkëpunimi me i mire me qytetaret e komunës se Deçanit	fuqizimin e prodhueseve. -Mungesa e laboratorëve adekuat për cilësinë e prodhimit. -Mos plasimi i duhur ne tregun lokal dhe rajonal. -Mungesa e promovimit ne nivel lokal dhe ndërkombëtare.
11.Inicimi i procedurave dhe krijimi i Strategjisë Lokal të Zhvillimit Ekonomik për Komunën e Deçanit.	DEZH, Organizata Jo-Qeveritare dhe Vendore, Organizatat Ndërkombëtare, Ekspert të Fushave të Ndryshme	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit, Donator dhe Ndërkombëtar	-Krijimi i një plani afat gjatë për zhvillimin ekonomik. -Gjendja ekonomike dhe sociale e tanishme. -Veprimet qe duhet merren për zhvillimin ekonomik, turizmit dhe bizneseve në Deçan. -Nxitja e bashkëpunimit mes institucioneve dhe qytetareve.	-Mungesa e përkrahjes financiare. -Mos përkrahja nga institucionet lokale dhe qendrore. -Mos zbatimi i kësaj strategjie pas hyrjes ne fuqi.
12.Bashkpunimi me institucionet qendrore, organizata ndërkombëtare, organizata jo-qeveritare dhe ndërkombëtare, me ekspert të ndryshëm	DEZH, Ministrit, Organizatat Jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, Ekspert të ndryshëm, Institucione tjera shoqërore.	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore dhe Organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare.	-Krijimi i bashkëpunimit me të mire mes institucioneve. -Krijimi i kushteve me të mira sociale dhe ekonomike të qytetareve.	-Mos bashkëpunimi i mirë mes institucioneve. -Procedurat administrative. -Mos planifikimi i duhur buxhetor, i

dhe institucione tjera shoqërore.				-Informimi i duhur i qytetareve për çështje të ndryshme. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	kohës dhe mungesa mjeteve administrative.
13.Informimi dhe mbështetje bizneseve lokale në aplikime të ndryshme për grante si në institucionet qendrore ashtu dhe ndërkombëtare	DEZH, Ministrit, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare, Bizneset Lokale	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore dhe Organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare.	-Informimi me i mire i qytetareve. -Krijimi i mundësimeve për ngritjen e kapaciteteve prodhuese. -Fuqizimin e bizneseve lokale. -Zhvillimin ekonomik i komunës.	-Mos informimi me kohe i bizneseve. -Mungesa e kuadrove profesionale brenda drejtorisë dhe të bizneset. -Procedurat aplikuese të vështira.
14.Funksionalizimi dhe punësimi i dy personave që njohin gjuhë të huaja dhe fushën e turizmit në Qendrën Informuese Turistike.	Komuna e Deçanit DEZH	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore dhe Organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare.	-Informimi me i mire i turistëve për vlerat natyrore dhe kulturore të komunës. -Rritja e numrit të turistëve. -Promovimi i turizmit në nivel vendor dhe ndërkombëtare.	-Mungesa e materialeve promovuese. -Mungesa e kuadrove profesionale në fushën e turizmit. -Mungesa e mjeteve buxhetore për punësimin e personave dhe mos funksionalizimi i duhur i qendrës informuese.
15.Projekti Zgjerimi i Via Dinarica në Rajonin Nderkufitare Kosove-Shqiperi	CDF Komuna e Deçanit Qytetaret e komunës së Deçanit	Janar – Gusht 2023	Komuna e Deçanit Bashkimi Evropian CDF	-Krijimi i shtigjeve të reja në zonat malore në Kosovë dhe në Shqipëri	-Kushtet klimatike -Proceduar administrative. -Mos pagesa me kohe e

Komuna e Decanit-CDF	Shoqata lokale te bjeshkatave		Komunat tjera të përfshira ne ketë projekt	VIA DINARICA. -Trajnime te antareve shoqatave bjeshkatave lokale. -Promovim turizmit malore dhe materialeve tjera promovuese.	mjeteve buxhetore nga ana e komunave.
16.Krijimi i zyrës së hartimit të projekteve në kuadër te Drejtorisë dhe punësimi me kohë të caktuar ose të plote ne ketë zyre.	Komuna e Deçanit, Organizata Qeveritare Vendore dhe ndërkombëtare	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit Institucionet Qendrore dhe Organizata Vendore dhe ndërkombëtare	-Mbështetje qytetareve dhe bizneseve ne aplikim për projekte të ndryshme. -Hartimi i projekteve fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik. -Krijimi i shërbimeve me te mira për qytetaret.	-Mungesa e mjeteve buxhetore. -Mos përkrahja nga institucionet qendrore dhe lokale për hapjen e kësaj zyre.
17.Dita e Qethave	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe ndërkombëtare Qytetaret e Komunës se Deçanit Bizneset Lokale	Korrik 2023	Komuna e Deçanit DEZH Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe ndërkombëtare	-Ruajtja e vlerave natyrore dhe tradicional të komunës. -Promovimi i turizmit malor dhe natyrore. -Promovimi i ushqimit tradicional. -Fuqizimi i blegtoveve dhe pronareve të bujtinave. -Ngritja e kapaciteteve	-Kushtet klimatike. -Mungesa e mjeteve financiare. -Mungesa e ushqimit natyral dhe blegtoveve ne zonat malore. -Mungesa e bagëtive ne zonat malore. -Harresa dhe mos interesim për ruajtjen e

				<p>mikpritëse të pronareve të staneve në zonat malore.</p> <p>-Rritja e numrit të turistëve që vizitojnë zonat malore.</p> <p>-Zhvillimi ekonomik i komunës.</p>	<p>vlerave tradicionale.</p>
18.Blerja e produkteve të turizmit	Komuna e Deçanit	Mars 2023	Komuna e Deçanit DEZH	<p>-Me furnizimin e Qendrës Informuese Turistike në Deçan me produkte të reja synojmë që të arrijmë në shtimin e mundësisë për përjetimin e bukurive natyrore si dhe artificiale të krijuar si atraksione turistike në komune e Deçanit</p>	<p>-Mungesa e fondeve për blerjen e pajisjeve</p> <p>-Cilësia e dobët e pajisjeve</p> <p>-Mos përdorimi i tyre adekuat etj.</p>
19.Gara e Skijimit-Kupa e Gjeravicës Bjeshka e Belegut	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatrat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetaret e Komunës së Deçanit Bizneset Lokale Ekspert të ndryshëm	Mars 2023	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatrat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetaret e Komunës së Deçanit Bizneset Lokale Ekspert të ndryshëm	<p>-Promovimi i turizmit dhe sportit dimërore</p> <p>-Krijimi i Bjeshkës e Belegut si qendër e skitarisë.</p> <p>-Fuqizimi ekonomik i komunës</p> <p>-Gara e Skijimit-Kupa e Gjeravicës të njihet si gare</p>	<p>-Kushtet klimatike</p> <p>-Mungesa e mjeteve financiare për mbajtjen e garës dhe krijimin e qendrës së skijimit.</p> <p>-Mos njohja e garës në nivel nacional dhe ndërkombëtar.</p> <p>-Mos promovimi i</p>

	Tour Operator vendor dhe ndërkombëtare Federata e Skitaris se Kosovës.		Tour Operator vendor dhe ndërkombëtare Federata e Skitaris se Kosovës.	nacionale dhe ndërkombëtare.	garës ne nivel ndërkombëtar dhe rrjete ndryshme sociale
20.Projekte infrastrukturore në fushën e ekonomisë dhe ngritjes kapaciteteve turistike	Komuna e Deçanit DEZH DUPH Institucione Vendore dhe Ndërkombëtare Organizata Jo – Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit DEZH DUPH Institucione Vendore dhe Ndërkombëtare Organizata Jo – Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare -Biznese Lokale dhe Ndërkombëtare	-Zhvillimi ekonomik dhe rritja e punësimit në komune. -Përmirësimi dhe ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të pronareve të kullave, bujtinave, hoteleve në komune si zona rurale dhe malore. -Hapja e bizneseve të reja. -Krijimi i mundësive me te mira për qytetaret dhe bizneset.	-Mungesa e mjeteve financiare . -Procedurat administrative dhe aplikuese te vështira. -Mungesa e kuadrove apo ikja e tyre jashtë vendit.
21.Organizmi për ditën e Çlirimit të Deçanit – Ngjitja në Via Ferrata	Komuna e Decanit DEZH	Qershor 2023	Komuna e Deçanit DEZH	-Promovimi i atraksionit turistike Via Ferrata në Deçan -Respektimi i të gjithë atyre qe kontribuan ne çlirimin e Deçanit përmes micave me logo të komunës dhe ngjitja simbolike në pjesën ku	-Mos pjesëmarrja ne organizim -Kushtet klimatike

				shihet qyteti i Deçanit nga Kerrshat e Qelisë -Promovimi i bukurive natyrorë te Deçanit, gjate ngjitjes dhe gjate pjesës se hikingut	
22.Organizimi i Koncertit për ditën e Çlirimit të Deçanit	Komuna e Deçanit DEZH DRKS	Qershor 2023	Komuna e Deçanit DEZH DRKS	-Përmes koncertit qe do te mbahet ne sheshin e qyteti, komuna e Deçanit mundohet qe te promovoj edhe artistet e rinjtë nga qyteti i Deçanit	-Mos pjesëmarrja ne organizim -Kushtet klimatike -Mungesa e financimit për organizim
23.Organizimi i ecjeve në të gjitha bjeshkët e komunës se Deçanit	Komuna e Deçanit	Janar - Dhjetor 2023	Komuna e Deçanit Shoqatat bjeshkatore	-Promovimi i potencialit turistike te bjeshkëve nga Parku Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna" -Lëvizjen e njerëzve me qëllim rekreacioni, argëtimi, shërimi dhe zgjerimi të njohurive kulturore etj.	-Kushtet klimatike te këqija -Mungesa e sigurimit te fondeve -Mungesa e interesimit për të marre pjese në aktivitet qe do organizohen gjatë 12 muajve të vitit.
24. Organizimi i javës se turizmit	Komuna e Deçanit	Gusht 2023	Komuna e Deçanit Organizatet vendore si dhe Ndërkombëtare etj	-Promovimi i vlerave nga potenciali turistike natyror si dhe kulturore nga	-Kushtet Klimatike -Mungesa e sigurimit te fondeve për organizimin e

				komuna e Deçanit	aktiviteteve qe planifikojmë
25. Trajnimet në Qendrën e Informuese Turistike	Komuna e Deçanit	Mars-Shtator 2023	Komuna e Deçanit Organizatrat Jo-Qeveritare Vendore dhe ndërkombëtare Qytetaret e Komunës së Deçanit	-Trajnimi i menaxhereve të gastronomisë në lidhje me promovimin e produkteve të tyre në platformat ndërkombëtare të internetit -Njoftimi i tyre në lidhje me reklamën e produkteve dhe rëndësia e promovimit në website ndërkombëtare të internetit etj.	-Mos pjesëmarrja e tyre në trajnim -Mungesa e fondeve për organizmin e trajnimeve
26. Aktivitet neper shkolla për promovimin e turizmit	Komuna e Deçanit	Mars 2023	Komuna e Deçanit Organizatrat Jo-Qeveritare Vendore dhe ndërkombëtare	-Përmes aktiviteteve neper shkollat e komunës se Deçanit, synojmë te arrijmë ne informimin sa me te sakët dhe orientimin e të rinjëve në trajnimin e guidave qe do kontribuojnë ne promovimin e turizmit nga potenciali i bukurive te bjeshkëve tona.	-Mungesa e interesimit nga te rinjtë -Mungesa e sigurimit te fondeve për realizimin e aktiviteteve etj.
27. Dita e Gështenjës	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore,	Tetor 2023	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore,	-Ruajtja e promovimi i produkteve natyrore.	-Kushtet klimatike. -Mungesa e mbështetjes financiare.

	Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetaret e Komunës së Deçanit Bizneset Lokale Ekspert të ndryshëm Tour Operator vendor dhe ndërkombëtare		Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe ndërkombëtare Qytetaret e Komunës së Deçanit	-Fuqizimi i bizneseve për grumbullim dhe shitjen e gështenjës. -Rritjen e numrit të turistëve në zonat rurale. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	-Mos interesim për ruajtjen dhe shitjen e produkteve natyrore dhe vendore.
--	--	--	--	---	--

I nderuar Kryetar,

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka nevoj që në kuadër të saj, të ketë dhe katër zyrtar me kohe të caktuar ose të pa caktuar, të cilët dy do të punojnë në zyrën për ekonomi, për ndihem dhe mbështetjen të bizneseve për aplikime për grante të ndryshme, ndihmë dhe mbështetje rreth procedurave të regjistrimit bizneseve dhe zbatimit të rregullores për orarin e punës. Poashtu edhe dy zyrtar që njohin angleze dhe kane përvojë në fushën e turizmit dhe ekonomisë që të punojnë në Qendrën Informuese Turistike. Poashtu drejtoria ka kërkesa të shumta nga ana e bizneseve dhe qytetareve qe komuna apo drejtoria të ndan subvencione apo grante qe mbështesin hapjen e bizneseve te reja, bizneseve prodhuese dhe ato tregtare në Komune.

Shpresoj qe këto kërkesa dhe sugjerime do të merren për baze, si drejtori do të mundohemi të përmbushim dhe realizojm objektivat dhe aktivitetet e këtij plani me përkrahjen e juaj dhe institucioneve tjera.

Me respekt,

Isuf Demhasaj